

AUTONOMIA

PUBLIKIM I SHOQATËS PËR AUTONOMINË VENDORE

VENDORE



autonomia
vendore



demokracia
lokale



decentralizimi



rritja e
kapaciteteve





zhvillimi
lokal



mbrojtja e
mjedisit

PËRMBAJTJA

Mesazh	03
Forum FKDL	06
Rreth Nesh	10
Decentralizimi	12
Rritja e Kapaciteteve	14
Mbështetja Komunitare	18
Advokimi i Pushtetit Vendor	20
Bashkëpunimi Ndërkombëtar	21
Publikime dhe Çertifikime	23
Anëtarët	24
Partnerët	25





FORUMI KOMBETAR PER
**DEMOKRACI
LOKALE2024**



Mirëqeverisja Vendore: Transparencë dhe Përgjegjësi Vendimmarrëse



Rruga jonë drejt Bashkimit European, tashmë e afërt, është e kushtëzuar nga bashkëveprimi sistematik mes qeverisë, pushtetit vendor dhe gjithë aktorëve të tjerë socialë. Forume si ky janë ndër mjetet më të mira për të realizuar këtë ndërveprim mes aktorëve.

Z. Arbjan Mazniku
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

Forumi Kombëtar për Demokraci Lokale shërben si një platformë e përhershme dialogu, për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe forcimin e qeverisjes vendore. Si kryetar i Shoqatës për Autonominë Vendore, jam shumë optimist për frymën përbashkuese që nxit ky Forum mes aktorëve kyç të qeverisjes lokale, në një dialog konstruktiv për të ardhmen. Kjo nismë reflekton angazhimin tonë për të përshpejtuar procesin e integritit evropian në nivel vendor, duke i'u përgjigjur nevojave të komunitetit për zhvillim të qendrueshëm, mirëqeverisje dhe më shumë autonomi lokale.

Z. Erion Veliaj
President, Shoqata për Autonomi Vendore





Zvicra qëndron përkrah Shqipërisë në rrugëtimin e saj drejt një qeverisjeje transparente, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse.

Znj. Ruth Huber

Ambasadore e Konfederatës së Zvicrës në Tiranë

Autoritetet vendore janë të domosdoshme për demokracinë dhe janë aktore kyç në zbatimin e politikave të përbashkëta evropiane. Roli i bashkive në procesin e integritimit në BE është thelbësor. Bashkimi Evropian ka mbështetur në mënyrë aktive autonominë vendore në Shqipëri përmes iniciativave dhe projekteve të ndryshme të orientuara në forcimin e qeverisjes vendore dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

Znj. Cinzia Tarletti

Këshilltare, Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit, Delegacioni i BE-së





FORUMI KOMBËTAR PËR
DEMOKRACINË
LOKALE 2024

Sesioni 1: Performanca Kombëtare e Bashkive
Gjetjet dhe rekomandimet nga perspektiva e autoriteteve, donatorit, ekspertëve dhe përfutësve



Znj. Adela Dineva



Z. Pjetri Haxhiu



Z. Franë Haxhiu



Z. Franë Haxhiu



Dr. Valbona Karaka



Z. Pjetri Haxhiu

FORUMI KOMBËTAR PËR DEMOKRACI LOKALE
MIRËQEVERSIJE VENDORE

FORUMI KOMBËTAR PËR DEMOKRACI LOKALE

#Mirëqeverisja Vendore

Shoqata për Autonominë Vendore organizojë për herë të parë **Forumit Kombëtar për Demokraci Lokale** me temë “Mirëqeverisja Vendore: Transparencë dhe Përgjegjësi Vendimmarrëse”. Ky Forum i përvitshëm është një platformë dialogu në funksion të demokracisë lokale që fton në bashkëveprim të gjithë aktorët e tij.

Forumit u organizua në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore (AMVV), me mbështetjen dhe përkujdesin e veçantë të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Z. Arbjan Mazniku, dhe mbështetjen organizative të Qeverisë Zvicerane.



Forumit ishte i ndarë në tre panale kryesore ku përfaqësues të të gjitha niveleve ndan përvojat dhe diskutuan mbi aspekte të rëndësishme të mirëqeverisjes lokale si performanca, gjithëpërfshirja dhe bashkëqeverisja si dhe vendimmarrja bazuar mbi të dhënat.

Gjetjet dhe rekomandimet e dala nga ky Forum do të ndiqen me qëllim trajtimin e tyre në vijim duke përdorur të gjitha mekanizmat ligjor dhe qytetar për të adresuar sipas funksioneve zgjidhje efektive.







ADELINA FARRICI
DREJTORE EKZEKUTIVE
SHOQATA PËR AUTONOMI VENDORE

SHAV mbetet e përkushtuar për të bashkëpunuar me të gjithë aktorët lokal, qeverisjen qendrore dhe donatorët e huaj për të çuar përpara zhvillimin e kapacitetit të bashkive, autonominë vendore dhe demokracinë lokale, përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe integrimin e tyre evropian. Ne jemi të vetëdijshëm se bashkitë dhe shoqata kanë një rol të veçant dhe janë pjesë përbërëse në proceset zhvillimore dhe integruese për qytetet dhe vendin. Unioni ynë është instrumenti më i mirë në duart tona, i cili me peshën e tij unifikuese mundëson vemendje të shtuar, më shumë burime dhe kapacitete për zhvillim dhe mirëqenie lokale në bashkitë tona.

Krahas organizimi të Forumit Kombëtar për Demokraci Lokale këtë vit lançuar edhe Forumet e SHAV të cilat shërbejnë për adresimin e çështjeve me rëndësi të pushtetit vendor dhe dhënien e rekomandimeve mbi projektligjet sektoriale:



Forumi për
Financat Vendore




Forumi për
Menaxhimin të Mbetjeve



Forumi për
Energjinë dhe Klimën



Forumi për
Çështjet Social



SHOQATA
PËR AUTONOMINË
VENDORE

Së bashku
ndërtojmë
të ardhmen e
komunitetit

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHAV
TIRANË, 2023

RRETH NESH

Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV) u themelua në 12 Janar 2010, si një bashkim vullnetar dhe i pavarur i Bashkive të Republikës së Shqipërisë, me misionin për më shumë autonomi vendore përmes forcimit e zhvillimit të strukturave dhe mekanizmave demokratik në organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore.



Vizioni i SHAV mbetet forcimi i të drejtave dhe lirive të Njësive të Vetqeverisjes Vendore si një parakusht për zgjidhjen e problemeve të komuniteteve lokale, duke qënë më pranë tyre përmes gjithëpërfshirjes, shërbimeve cilësore dhe kompetencave në vendimmarrje.

Na kontaktoni:



Rruga "Brigada e VIII", Pallati 130,
shkalla 2 ap. 8, Tirana, Albania



info@shav.al



www.shav.al



@shoqataperautonomivendore



autonomia_vendore

KONCEPTI I PILOTIMIT

- **Pjesëmarrësit në pilotim:** katër bashki me madhësi dhe shpërndarje gjeografike të ndryshme, si dhe sfida komplekse në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe bujqësisë.
 - **Bashkitë:** Shkodër, Berat, Kolonjë, Divjakë
 - **Kohëzgjatja:** 12 muaj
 - **Monitorimi i pilotimit:** bord koordinues me pjesëmarrjen e Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor dhe palëve në marrëveshje.
- Raport përmbyllës i pilotimit:** analizë e procesit, gjetjeve dhe rekomandimeve për të thelluar dhe shtrirë më tej procesin e decentralizimit.



DECENTRALIZIMI I MË SHUMË FUNKSIONEVE NË FUSHAT E ARSIMIT,
SHËNDETËSISË DHE BUJQËSISË
TIRANË, MSHPV



DECENTRALIZIMI

#Decentralizimi Asimetrik

Decentralizimi asimetrik përfaqëson një qasje inovative për transferimin e funksioneve dhe kompetencave nga qeveria qendrore tek njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJQV), duke marrë parasysh kapacitetet dhe specifikat e secilës bashki. Nismat e SHAV në bashkëpunim me Qeverinë Zvicerane synjnë të forcojnë autonominë vendore dhe të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve publike, duke u bazuar në standarde të qarta dhe financimi të përshatshëm. Ky bashkëpunim ka përfshirë takime të shpeshta të grupeve teknike dhe konsultime me një sërë aktorësh të niveleve të qeverisjes dhe pilotime në disa bashki të vendit.





TRAJNIM MBI PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE NË INFRASTRUKTURË.
KORÇË, DHJETOR

RRITJA E KAPACITETEVE



#RCDN (Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve të Ujësllës Kanalizime)



Në kuadër të projektit RCDN+ (Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve për Shërbimet e Ujësllës Kanalizimeve), i implementuar nga GIZ dhe financuar nga SECO, Shoqata ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të mbështetur dhe fuqizuar njësitë e vetëqeverisjes vendore.

- **Forumet e Shoqërive të UK-ve:** SHAV ka marrë pjesë në takime dhe vizita studimore për të themeluar forume të përhershme si struktura rekomanduese dhe këshilluese, duke sjellë më afër nevojat e pushtetit lokal me shërbimet e ujësllës-kanalizimeve.
- **Trajnimi Gjenerik i Trajnerëve:** SHAV ka zhvilluar programe trajnimi për të rritur kompetencat metodologjike dhe profesionale në sektorin e ujit, duke siguruar përputhshmëri me standardet e cilësisë së RCDN.
- **Shkëmbimi i përvojave rajonale:** Përfaqësues nga bashkitë dhe shoqatat kanë shkëmbyer eksperiencë me Asociacionin e Komunave të Kosovës, duke ndërtuar modele të reja bashkëpunimi dhe zhvillimi.

Këto aktivitete janë një hap i rëndësishëm drejt forcimit të autonomisë vendore dhe përmirësimit të shërbimeve publike në nivel lokal.

A top-down view of a desk with various objects including books, a pen, a plant, a pocket watch, and a candle. The scene is brightly lit, creating soft shadows. The objects are arranged in a way that suggests a workspace or a place of study and reflection.

RRITJA E KAPACITETEVE PROFESIONALE TË ADMINISTRATËS VENDORE
AKADEMIA E PUSHTETIT VENDOR

RRITJA E KAPACITETEVE

#AkademiaePushtetitVendor

Ngritja e Akademisë së Pushtetit Vendor përfaqëson një hap të rëndësishëm në përpjekjet për forcimin e qeverisjes vendore dhe përmirësimin e kapaciteteve të administratës lokale në Shqipëri. Kjo iniciativë është produkt i vullnetit të pushtetit qendror, e nisur nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe mbështetet nga projekti "Bashki të Forta", AMVV, SHAV, donatorë dhe organizma të tjerë shtetëror.

Akademia synon të rrisë kapacitetet profesionale për mbi 26,000 punonjës të administratës lokale dhe të zgjedhurve vendor, përmes trajnime dhe kualifikime të avancuara, duke përmirësuar aftësitë e tyre për të ofruar shërbime publike me standarde europiane.

SHAV ka qenë një partner i rëndësishëm në këtë proces, duke organizuar tryeza konsultative dhe forume me aktorë të rëndësishëm si dhe ka asistuar gjithashtu në hartimin e propozimeve për strukturën, financimin dhe funksionimin e Akademisë.



PROJEKTI "SORI 3", BASHKIA MAT
FUQIZIMI I GRAVE NË KOMUNITET

MBËSHTETJA KOMUNITARE

#Qeverisja e Hapur

SHAV është e përkushtuar për të promovuar qeverisjen e hapur, transparencën dhe përfshirjen qytetare në proceset vendimmarrëse, duke ndihmuar bashkitë të ndërtojnë një marrëdhënie më të fortë dhe të besueshme me komunitetet e tyre. Në këtë kuadër, SHAV ka ndërmarrë një sërë iniciativash dhe bashkëpunimesh për të forcuar qeverisjen vendore dhe për të rritur pjesëmarrjen qytetare.

Në bashkëpunim me NDI Albania - (National Democratic Institute), SHAV ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa Bashki të vendit, duke punuar me kryetarët respektiv të këtyre bashkive për të promovuar transparencën dhe përfshirjen qytetare në vendimmarrje, në përputhje me parimet e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (OGP).

Në vijim zhvillimi i seminareve për qeverisje transparente, kanë mundur trajnimin e përfaqësuesve të pushtetit vendor mbi konceptet dhe praktikën e qeverisjes transparente. Këto aktivitete synojnë të pajisin drejtuesit lokalë me njohuri dhe mjete për të rritur përfshirjen e qytetarëve në politikbërje dhe për të përmirësuar qeverisjen vendore.



ASISTENCA



KËSHILLI KONSULTATIV QEVERISJE QENDRORE-VENDORE

ADVOKIMI I PUSHTETIT VENDOR

Pjesëmarrja në Këshillin Konsultativ Qeverisje Qendrore-Vendore është një mundësi për të gjithë aktorët e pushtetit lokal që të luajnë një rol aktiv në advokimin dhe lobimin e interesave të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV). Këto takime janë platforma kyçe për diskutimin dhe miratimin e projektakteve që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin dhe autonominë e pushtetit vendor.

#INSTITUCIONET

#Rritja e pagave dhe përmirësimi i kushteve të punës

#Financat Vendore

#përmirësimi i strukturave administrative

#Ndryshime në legjislacion dhe rregullore

#Menaxhimi i mbetjeve

#Transferimi i pronave dhe përmirësimi i shërbimeve sociale

SHAV mbetet e angazhuar të vijojë bashkëpunimin dhe lobimin me të gjithë aktorët kryesor për më shumë autonomi, mbështetje dhe të drejta që adresojnë zgjidhje dhe përmirësojnë cilësinë e jetës së komuniteteve lokale në vend.





BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Gjatë këtij viti SHAV ka marrë pjesë në një sërë takimesh dhe konferencash ndërkombëtare me fokus shkëmbimin e përvojave, tërheqjen e asistencës teknike dhe mbështetjen financiare nga projekte ndërkombëtare në fushën e pushtetit vendor, si dhe kemi ofruar kontributin tonë në hartimin e politikave dhe koordinimin rajonal me homologët tanë.

#20Vjet Nalas

Rrjetit të Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore ka luajtur një rol thelbësor në forcimin e shoqatave të qeverisjes vendore përmes dhënies së asistencës teknike duke adresuar çështje të rëndësishme si forcimi i autonomisë vendore, rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor, migrimi, çështjet sociale, transformimi dixhital e shumë të tjera, si dhe duke forcuar zërin e qeverisjes vendore në rajon.

#KlimaDheEnergjia

Në kuadër të projektit "EU4ET Covenant of Mayors in the Western Balkans and Türkiye", SHAV ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes për hartimin dhe zbatimin e strategjive për energjinë dhe klimën.

Lançimi i Forumit për Energjinë, Klimën dhe Mobilitetin Urban të **#SHAV**, i cili synon të adresojë sfidat dhe mundësitë për një të ardhme më të qëndrueshme energjetike dhe klimatike në rajon.



BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR



#Mobiliteti

Në bashkëpunim me projektin "ProSUMP", po punojmë për promovimin e praktikave të gjelbra në transport dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme urbane. Përmes rrjeteve tona, kemi diskutuar zgjidhje inovative për transportin publik, financimin dhe teknologjitë e reja për rritjen e efikasitetit në komunitet.



#Forcimi i Bashkëpunimit

Pjesëmarrës në javën e 22-të Evropiane të Rajoneve dhe Qyteteve, në Bruksel, ku ndamë eksperiencat me vendet Evropiane në drejtim të përballimit të sfidave klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të qyteteve. Ky aktivitet ishte një mundësi e mirë për të eksploruar se si qytetet dhe rajonet mund të punojnë së bashku për të adresuar ndryshimet mjedisore, për të promovuar qëndrueshmërinë dhe për të nxitur rritjen përmes partneriteteve.

#ShkëmbimPërvojash

Në Serbi me "Grupin e Punës mbi Përfshirjen Sociale dhe Migrimin", i cili u zhvillua në kuadër të projektit "Bashkëpunimi Rajonal për Përfshirje më të Mirë Sociale në Nivel Lokal", mbështetur nga NALAS dhe GIZ, ndamë gjetjet paraprake të Udhërrëfyesve të Avokimit për Përfshirje Sociale në Nivel Lokal.



PUBLIKIME DHE CERTIFIKIME

Shoqata për Autonomi Vendore gjatë këtij viti ka prodhuar një sërë dokumentesh advokuese dhe pozicionuese aspekte të rëndësishme të pushtetit vendor siç është Akademia për Pushtetin Vendor, Grantin e Performancës dhe Decentralizimin Simetrik. Gjithashtu, në vijim ka prodhuar dokumente promovuese të modeleve dhe praktikave më të mira të bashkive mbi menaxhimin e mbetjeve, arsimin parashkollor dhe zbatimin me sukses të projekteve të mbështetura financiarisht nga donatorët.



SHAV është tashmë anëtare e rrjetit ICLEI - Qeverisjet Lokale për Qëndrueshmëri, një rrjet global që mbështet ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për qytetet dhe komunitetet në mbarë botën. Përmes ICLEI-South Asia, SHAV do të marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare, forume tematike dhe takime profesionale me ekspertë globalë, duke forcuar angazhimin për një të ardhme më të gjelbër dhe të qëndrueshme për pushtetin vendor.



ANËTARËT



Bashkia Besh



Bashkia Brat



Bashkia Bulqizë



Bashkia Cërrik



Bashkia Delvinë



Bashkia Devoll



Bashkia Libohovë



Bashkia Librazhd



Bashkia Lushnjë



Bashkia Malësi e Madhe



Bashkia Maliq



Bashkia Mallakastër



Bashkia Dibër



Bashkia Divjakë



Bashkia Dropull



Bashkia Durrës



Bashkia Elbasan



Bashkia Fier



Bashkia Mat



Bashkia Memaliaj



Bashkia Mirditë



Bashkia Patos



Bashkia Peqin



Bashkia Përmet



Bashkia Fier



Bashkia Fushë-Arrëz



Bashkia Gjirokastrë



Bashkia Gramsh



Bashkia Has



Bashkia Himarë



Bashkia Pogradec



Bashkia Poliçan



Bashkia Prrenjas



Bashkia Pukë



Bashkia Pustec



Bashkia Roskovec



Bashkia Kamëz



Bashkia Kavajë



Bashkia Këlcyrë



Bashkia Klos



Bashkia Kolonjë



Bashkia Konispol



Bashkia Rrogozhinë



Bashkia Selenicë



Bashkia Shijak



Bashkia Skrapar



Bashkia Tepelenë



Bashkia Tiranë



Bashkia Korçë



Bashkia Krujë



Bashkia Kuçovë



Bashkia Kukës



Bashkia Kurbin



Bashkia Lezhë



Bashkia Tropojë



Bashkia Dimal



Bashkia Vau i Dejës



Bashkia Vlorë



Bashkia Vorë



Bashkia Shkodër



Bashkia Sarandë


PARTNERËT

Shoqata për Autonomi Vendore, ka për qëllim të llojë e të jetë një zë i fuqishëm në bazë të politikave e të vizionit të cilat janë paraqitur në statut, për të mbrojtur e monitoruar interesat e anëtarësisë. Ndaj për ne partneriteti dhe bashkëpunimi me shoqatat homologe ndërkombëtare në përfundim e përvajave më të mira europiane dhe rajonale është një domosdoshmëri. Sot, Shoqata operon në partneritet të ngushtë me rrjetet më të rëndësishme të shoqatave lokale të BE dhe Europës Jug-Lindore dhe është një anëtare me të drejta të plota në European Association for Local Democracy.





Për më shumë rreth nesh ju ftojmë të lundroni në faqen tonë të web-it:

www.shav.al





Na kontaktoni:

 Rruga "Brigada e VIII", Pallati 130,
shkalla 2 ap. 8, Tirana, Albania.

 info@shav.al

 www.shav.al

 [@shoqataperautonomivendore](https://www.facebook.com/shoqataperautonomivendore)

 [autonomia_vendore](https://www.instagram.com/autonomia_vendore)



SHOQATA
PER AUTONOMINE
VENDORE

Falenderojmë ekipin e Shoqatës për Autonomi Vendore (SHAV), Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, AMVV, bashkitë dhe partnerët tanë kryesorë, donatorët dhe ekspertët, dhe aktorët e tjerë të pushtetit vendor dhe qendror, të cilët me përfshirjen dhe mbështetjen e tyre në veprimtarinë sektoriale të shoqatës kanë kontribuar në mundësimin e kësaj broshure.

© 2024 Shoqata për Autonomi Vendore